



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Mars 2022

Nr: 117

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN,  
AMBASADËS SUEDEZE DHE AMBASADËS BRITANIKE PËR VËZHGININ E  
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 2.3.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

- KËRKUES:**
1. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, me seli në Tiranë, Rruga “Papa Gjon Pali II ” dhe përfaqësues z. Luigi Soreca;
  2. Ambasada e Suedisë me seli në Tiranë, Rruga “Pjetër Budi” dhe përfaqësuese zj. Elsa Hastad;
  3. Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, me seli në Tiranë, Rruga “Skenderbeg” Nr.12 dhe përfaqësues z. Alastair King-Smith.

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”



## VËREN:

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) vëzhgues afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Suedisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 6 (gjashtë) vëzhgues afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Suedisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Britanisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Suedisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



## V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 9 (nëntë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyesve të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 6 (gjashtë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve të Ambasadës së Suedisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 9 (nëntë) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës së Britanisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

